Raport për punën në N.P"KOMUNALE"-Strugë,për periudhën prej datës 01.01-30.09.2018,si dhe krahasimi me rezultatet e arritura financiare për periudhën prej datës 01.01-30.09.2017.

Nëpërmjet raporteve financiare duhet të sigurohen informacione për gjendjen financiare dhe punën e ndërmarrjes,të cilat do të shfrytëzohen për sjelljen e drejtë të vendimeve ekonomike.Ata i tregojnë rezultatet e udhëheqjes dhe administrimin e mjeteve të besuara,gjegjësisht raportet financiare sigurojnë informacione për mjetet,kapitalin,detyrimet,të ardhurat dhe të dalurat duke e futur fitimin apo humbjen e ndërmarrjes.

TABELA nr.1

Pasqyrë tabelore e të hyrave e marrë në dy periudhat krahasuese prej datës 01.01-30.09.2018 dhe 01.01-30.09.2017.

NP"Komunale"-Strugë i ka përgatitur raportet e veta financiare në bazë të përllogaritjes.

| KONTO | EMRI | 01.01-30.09 2017 | 01.01-30.09 2018 | INDEKS |
|---|---|---|---|---|
| 7200 | TË ARDHURA TË PAZAKONTA | | | |
| 7400 | PASTËRTIA | 30907146 | 30910326 | 100.01 |
| 74003 | VEPRIMTARI FUNERALE | | | |
| 74004 | TË ARDHURA NGA MIRËMBAJTJA E VARREZAVE | 11500 | | 0.00 |
| 7401 | TË ARDHURA NGA PËRPUNIMI I PËRMENDOREVE | 108620 | 123800 | 113.98 |
| 74010 | TË ARDH NGA MBET E JASHT | 1219048 | 570046 | 46.76 |
| 74011 | TË ARDH NGA MIRMB E HGJ SË QYT | 4398733 | 4451653 | 101.20 |
| 74012 | TË ARDH NGA MIRMB E GJLB TË QYTETIT | 4606794 | 4606794 | 100.00 |
| 74014 | KUOTACIONI | 1128220 | 1132120 | 100.35 |
| 74016 | TË ARDH NGA V.PËR VARRIM | 420000 | 435000 | 103.57 |
| 74018 | TË ARDH NGA SHITJA SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7402 | TË ARDH NGA MORGU | 97244 | 156460 | 160.89 |
| 7404 | TREGJET KASA FISKALE | 250274 | 313551 | 125.28 |
| 74041 | TREGU ME SHUMICË--FISKALE | | 12905 | |
| 74043 | TË ARDH NGA PAGESA FISK NË TERREN | 26762 | 667 | 2.49 |
| 74044 | TË ARDH NGA PAGESA FISK-P.NDALESËS | 109367 | 110900 | 101.40 |
| 7406 | KONTRATA-TEZGA | 1400371 | 1498226 | 106.99 |
| 7407 | MERIMANGA | | | |
| 7409 | TË ARDH NGA SHRB E OPERATORIT | 94500 | 91500 | 96.83 |
| 74091 | SHËRB.TJERA-PUNIME GURI | 52800 | 57000 | 107.95 |
| 7431 | TË ARDH NGA SHITJA E PAJISJEVE TË AMORTIZUARA | | 147482 | |
| 7472 | TË ARDHURA NGA HUATË | 184686 | 105792 | 57.28 |
| 7600 | TË ARDH NGA SHITJA E MJETEVE TË PËRHERSHME | | | |
| 7650 | TË ARDH NGA SHLYREJA E DETYRIMEVE | | | |
| 7651 | TË ARDH NGA PAGESA E KËRKESAVE | | | |
| 7690 | TË ARDHURA NGA PENALIZIMET ETJ | 129505 | 101362 | 78.27 |
| 7699 | TË ARDHURA TË TJERA TE PAPERMENDURA | 209 | 11083 | 5302.87 |
| 7740 | TË ARDH NGA KAMATA | 73 | 19104 | 26169.86 |
| | GJITHSEJ | 45145852 | 44855771 | 99.36 |

Në pasqyrën tabelore nr.1 janë ta paraqitura të hyrat e realizuara sipas pozicioneve.Të hyrat e përgjithshme në vitin afarist 2018 janë ulur për 99.36 pikë indeksore në krahasim me vitin 2017 ose kemi ulje prej 290.081,00 denar.Vlera e të hyrave të përgjithshme është fituar si rezultat i rritjes ose zbritjes së të ardhurave individuale në njësitë punuese.

Në strukturën e përgjithshme të të hyrave në vitin 2018,pjesmarrje më të madhe kanë të ardhurat nga pastërtia me indeks prej 100.01% ose për 3.180,00 den, të ardhurat nga mbeturinat e jashtëzakonshme janë ulur për 46.76% pikë indeksore ose në masë për 649.002,00 den,në varësi të lejeve të dhëna për ndërtim në Komunën e Strugës. Të ardhurat nga mirëmbajtja e higjienës publike të qytetit në vitin vijues 2018 janë në rritje prej 101.20%për shkak të

rritjes së punëve të kryera në tremujorin e tretë në vitin actual dhe atë të kaluar 2017;të ardhurat për mirëmbajtjen e gjelbërimit të qytetit sipas punëve të parashikuara në programin e vitit 2018,janë në vlerën e njëjtë prej 100.00% krahasuar me vitin e klauar.Të ardhurat nga kuotizimi si pjesë e të ardhurave të faturizuara për pastërti,janë rritur për 100.35%ose për 3.900,00 den. Të ardhurat nga morgu në tremujorin e tretë kanë rritje prej 160.8 %ose për 59.216,00 den;të ardhurat nga shërbimet e operatorëve në varrezat e qytetit të Strugës ,janë ulur për 96.83% ose për 3.000,00 den; të ardhurat nga penalizimet,shpërblimet sipas lëndëve të paguara gjyqësore nga personat juridik dhe fizik janë ulur për 8.27%ose për 28.143,00 den.

Ulje ka te një pjesë e të ardhurave,dhe atë duke filluar nga të ardhurat për mirëmbajtjen e varrezave për 11.500,00 den.,për shkak të faturave të dorëzuara për mirëmbajtje për vitin punues 2017 në muajin shtator të vitit të kaluar,ndërsa për vitin 2018 janë të faturuara në muajin tetor,dhe kjo e dhënë do përfshihet në tremujrin e katërt deri më datën 21.12.2018. Të ardhurat nga përpunimi I bazamenteve ose kornizave rreth vend varrimit janë rritur për 113.98% ose për 15.180,00 den; të ardhurat nga dhënia e vendit për varrim në tremujorin e tretë kanë tendencë rritjeje për 103.57% ose në masë për 15.000,00 den. Të ardhurat nga tregjet-arka fiskale gjatë pagesës në vend në tremujorin e tretë ,janë rritur për 125.28 %pikë indeksore ose për 63.277,00 den; të ardhurat e kontratave për tezga për shkak të faturimit mujor ,në varësi të shfrytëzuesve të tezgave janë rritur për 106.99% ose për 97.855,00 den. Të ardhurat nga shërbimet për hyrjen e gurëgdhendësve në varrezat e qytetit të Strugës, në tremujorin e tretë janë rritur për 107.95% ose për 4.200,00 den;të ardhurat nga qiratë për shfrytëzimin e hapësirave para lokaleve afariste në tregun e qytetit,shënojnë ulje prej 57.28 % ose për 78.894,00 den; të ardhurat nga kamatat nga puna në bazë të marrëdhënies debitor-kreditor të vitit vijues janë rritur për 26169.86%ose për 19.031,00 den. Të ardhurat nga tregu me shumicë me fiskale janë rritur për 12.905,00 den; Të ardhurat nga fiskalja-e pikë ndalesës shënojnë rritje prej 101.40 % ose në masë për 1.533,00 den. Të ardhurat nga shitja e pajisjeve të amortizuara janë rritur për 147.482,00 den.Rritje ka edhe te të ardhurat të cilat llogariten si tç ardhura të tjera nga puna për 5302.87% ose për 10.874,00 den.

Përqindja nga pagesa e personave juridik është 58.53% ndërsa nga personat fizik me paralajmërim është 85.67%.

TABELA nr.2

Struktura e shpenzimeve për periudhën prej datës 01.01-30.09.2018 dhe krahasimi i të njëjtave me periudhën prej datës 01.01-30.09.2017.

| KONTO | EMRI | 01.01-30.09 2017 | 01.01-30.09 2018 | INDEKS |
|---|---|---|---|---|
| 40100 | SHPENZIMET PËR MATERIALE | 136160 | 75537 | 55.48 |
| 40101 | SHPENZIMET PËR L.PARË.MAT | 711005 | 442573 | 62.25 |
| 40103 | SHPENZIMET PËR MATERIALE ZYRE | 200124 | 289145 | 144.48 |
| 4013 | SHPENZIMET PËR PAISJE HTZ | 420180 | 82116 | 19.54 |
| 403000 | SHPENZIMET PËR E.ELEKTRIKE | 183912 | 181574 | 98.73 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 403001 | SHPENZIMET PËR E.ELEKTRIKE-VARREZA | 26697 | 34855 | 130.56 |
| 4031 | SHPENZIME PËR MAT.PËR NGROHJE | 68647 | 25423 | 37.03 |
| 4032 | SHPENZIMET PËR KARBURANT | 2214828 | 2495175 | 112.66 |
| 4034 | SHPENZIMET PËR LUBRIFIKANT | 237807 | 178044 | 74.87 |
| 40500 | SHPENZIMET PËR P.REZERV | 411721 | 421457 | 102.36 |
| 4070 | SHPENZIMET PËR INV E IMËT | 93361 | 122028 | 130.71 |
| 4071 | FSHIRJA E INV E IMËT NË PRDM | 53730 | 0 | 0.00 |
| 4072 | SHPENZIME PËR AUTO GOMA | 194887 | 76598 | 39.30 |
| 4100 | SHËRBIMET PËR TRANSPORT | | 110 | |
| 4110 | SHËRBIMET E PTT.TEL DHE INTERNET | 347179 | 422886 | 121.81 |
| 4119 | SHRB TJERA PËR PËRPUNIM | 89550 | 33402 | 37.29 |
| 4130 | SHËRBI PËR MIRËMBAJTJE | 218200 | 279651 | 128.16 |
| 4131 | SHËR PËR K.SHËNDETËSORE | | 24000 | |
| 4140 | QIRA PËR HAPËSIRA AFARISTE | | 4800 | |
| 41501 | TAKS KOMUNALE UJ I SHPENZ-VARR | | 10560 | |
| 41510 | SHËRBIME KOMUNALE-UJË I SHPEN- | | | 0.00 |
| 4146 | LIZING PËR MAKINA | | | |
| 41501 | TAKS KOMUNALE UJ I SHPENZ-VARR | | | |
| 41510 | SHËRBIME KOMUNALE-UJË I SHPEN- | 88154 | 178788 | 202.81 |
| 41708 | FLAERA DHE REKLAMA TË TJERA | | | |
| 4170 | SHPENZIME PËR REKLAMË DHE PRPG | | 49373 | |
| 4171 | SHPENZIME PËR PAGE G.ZYRTA | 18302 | | 0.00 |
| 4190 | SHËRBIME TË TJERA | 51979 | 72594 | 139.66 |
| 4191 | SHËRBIME TË TJERA-VARREZA | | | |
| 41944 | TAKSA E VEÇANTË E PAGESËS SË DETYRUESHME-TVSH | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 41921 | SHPENZIME PËR KËSHILLIM DHE SEMINARE | | | 0.00 |
| 4199 | SHËRBIME TË TJERA TË PAPËRMENDURA | 10423 | 38920 | 373.40 |
| 4200 | RROGAT DHE KOM E RROGAVE | 26631020 | 24958759 | 93.72 |
| 4220 | SHPENZIME PËR SHK.NGA PUNA | 67026 | | 0.00 |
| 42210 | SHK.NGA PUNA TË PNT-T.EKNOMIK | 133398 | 116307 | 87.19 |
| 42222 | NDIHMË NË RASTIN E VD SË PUNËTORIT | | | |
| 42241 | NDIHMË FAM.NË R.VDEKJE | 67542 | | 0.00 |
| 4400 | MËDITJET P UDH ZYRTAR | 16495 | 54900 | 332.83 |
| 4401 | KOMP E SHPNZ PËR TRANSPORT | 1620 | 3010 | 185.80 |
| 44001 | MËDITJE PËR UDH.ZYRTARE J.VENDIT | 44937 | | |
| 44011 | SHPENZIME PËR UDH.ZYRTARE J.VENDIT | 29600 | | 0.00 |
| 4411 | KOMPENSIM PËR SHFRYTËZIMIN E M.PRIVATE | | | |
| 4417 | DHURATA PËR PUNËTORËT PËR VITIN E RI | 7444 | 90000 | 1290.00 |
| 44200 | MËDITJE PËR K.D | 165500 | 542000 | 327.49 |
| 44425 | KONTRIBUTE –FONDI PËR UJË | | 1783 | |
| 4421 | SHPENZIME PËR REKLAMA | | | |
| 4430 | SHPENZIME PËR SPONSORIZIM | | | |
| 44301 | SPONSORIZIME PËR SUBJEKTE JURIDIKE | 14000 | 11000 | 78.57 |
| 44312 | DON PËR PRS.FIZIK | 22000 | 8233 | 37.42 |
| 4440 | SHPENZIME PËR PËRFAQËSIM | 958791 | 560402 | 58.45 |
| 44425 | KONTRIBUTE –FONDI PËR UJË | 1047 | 1783 | 170.30 |
| 4450 | SHPENZIME PËR SIGURIM | 63383 | 49450 | 78.02 |
| 4460 | SHPENZIME PER QAR.PGS | 54312 | 73769 | 135.82 |
| 4470 | TATIME QË NUK VAREN NGA REZ FINAN | 1723 | | |
| 44741 | TAKSA RADIO DIFUZIVE | 7980 | | 0.00 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 44743 | TAKSË KOMUNALE PËR NDRÇ-DR | 1395 | | |
| 447431 | TAKSË KOMUNALE PËR NDRÇ-VRR | 279 | | |
| 447434 | TAKSA TË TJERA | | | |
| 44761 | ANTARSIM PËR SHOQATA | 4800 | 66800 | 1391.67 |
| 44790 | SHPENZIME PËR DHËNIEN E AKTVENDIMEVE PËR VPR.KOMUNALE | | | 0.00 |
| 44791 | T.PERSONAL PËR PAG. K.V | 206527 | 469457 | 227.31 |
| 44797 | T.PERSONAL PËR SHKËPUTJE NGA PUNA | 2367 | 6764 | 285.76 |
| 44795 | T.PERSONAL PËR DONACIONE DHE SPONSOR | 31425 | 433 | 1.38 |
| 4490 | SHPENZIMET E GJYQIT | | 61310 | |
| 44900 | SHËRBIMET E MARK DHE KËSHI | | | 0.00 |
| 44903 | SHËRBIMET E AVOKATIT | 158718 | 135424 | 85.32 |
| 449031 | SHËRBIMET NOTERIKE | 970 | | 0.00 |
| 44905 | SHËRBIME PËR EKSPERTIZË | | | |
| 44904 | SHPËRBLIMET NOTERIKE | 62964 | | 0.00 |
| 44908 | SHPEN. PËR PUN TË PËRKH DH E TË ÇASTIT ME KONTR.P | 2140750 | 4206133 | 196.48 |
| 44909 | SHPENZIME PËR EKZEKUTIM | 25392 | 9939 | 39.14 |
| 44910 | SHPENZIME PËR VLERËSIM | | | |
| 4497 | SHPENZIME PËR REGJISTRIM | 9336 | 7892 | 84.53 |
| 4499 | SHPENZIME TJERA JOMATERIALE | 20719 | 46197 | 222.97 |
| 44994 | TAKSA ADMINISTRATIVE | 170 | 554 | 325.88 |
| 4550 | VLERS I KRK AFATSHKURTRA | | | |
| 4686 | DËNIME,PENALIZIME DHE KOM I DËMIT | | | |
| 4690 | DËME TË TJERA | | | |
| 4740 | SHPENZIME TË TJERA NË PUNË | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4740 | KAMATA NGA PUN ME SUB.TË PALIDH | 2358 | 42223 | 1790.63 |
| 4550 | VLERS I KRK AFATSHKURTRA | 640986 | 326130 | 69.73 |
| 47460 | KAMATAT NDËSHKUESE | 467680 | 246825 | 52.78 |
| | GJITHSEJ | 37841500 | 37637086 | 99.46 |

Në pasqyrën nr 2,janë të treguara shpenzimet e realizuara në periudhën prej datës 01.01-30.09.2018,të krahasuara me periudhën prej datës01.01-30.09.2017,ku mund të shihet se të dalurat sillen me dinamikën e uljes me indeks prej 99.46 pikë indeksore,ose kemi ulje të të dalurave në masë prej 204.414,00 den.

Të dalurat e përgjithshme që dalin nga shërbimet komunale mbulohen nga shërbimet e periudhës së përllogaritur.Nga tabela e mëparshme,mund të konstatojmë se ulje ka te shpenzimet për materialet për 55.17% ose për 60.623,00 den, te shpenzimet për lëndën e parë dhe materialet kemi ulje për 62.25% ose për 268.432,00 den,te shpenzimet për pajisjet e HTZ ka ulje prej 338.064,00 den ose me indeks prej 19.54%.shpenzimet për dru për ngrohje janë ulur për 37.03% ose për 43.224,00 den,në përputhje me nevojat në ndërmarrjen tonë.Ulje ka edhe te shpenzimet për lubrifikant për 74.87% ose për 69.763,00 den;edhe shpenzimet për autogomat kanë ulje në tremujorin e tretë të vitit vijues 2018 dhe atë për 39.30 %ose në masë për 118.289,00 den.Shërbimet për mirëmbajtje kanë rritje prej 128.16% ose për 61.451,00 den. Shërbimet për pagesën e gazetave zyrtare janë ulur dhe atë në vlerën prej 18.302,00 den;shpenzimet për shkëputje nga puna janë ulur për 67.026,00 den;ndërsa shkëputja nga puna e të punësuarve si tepricë ekonomike është për 17.091,00 den është paguar më pak në tremujorin e tretë të vitit aktual krahasuar me vitin e kaluar.Kompensimi I shpenzimeve për transport për udhëtimet zyrtare kanë rritje prej 185.80% ose për 1390,00 den;shpenzinet për përfaqësim në vitin vijues në tremujorin e tretë janë ulur për 58.45%ose për 398.389,00 den. Shpenzimet për taksën radio difuzive janë ulur për 7.980,00 den. Shpenzimet për punë të përkohshme dhe të çastit me kontratë pune janë rritur për 196.48% ose për 2.065.383,00 den.

Rritja te shpenzimet individuale shfaqet te shpenzimet e materialeve për zyra të cilat janë rritur për 144.48% ose për 89.021,00 den;shpenzimet për e.elektrike në varrezat e qytetit të Strugës janë rritur për 130.56% ose për 8.158,00 den;shpenzimet për karburant kanë tendencë ngritjeje në tremujorin e tretë të vitit vijues për 112.66% ose në masë për 280.347,00 den. Shpenzimet për pjesët rezervë për mjetet e përhershme bazë të cilat amortizohen në terren janë në rritje për 102.36 % ose për 9.736,00 den;gjithashtu edhe shpenzimet për inventarin e imët janë rritur për 130.71% ose për 28.667,00 den.Shërbimet e PTT shënojnë rritje me indeks prej 121.81 % ose për 75.707,00 den;shërbimet komunale për ujin e shpenzuar janë rritur për 202.81% ose për 90.634,00 den; shërbimet e tjera për mirëmbajtjen e mjeteve bazë janë rritur për 139.66% ose për 20.615,00 den;dhe të gjitha shërbimet e tjera të papërmnedura kanë tendencë rritjeje prej 373.40 %ose për 28.497,00 den. Shpenzimet për pagesën e rrogave dhe kompensimeve nga rroga(bruto) janë ulur për 93.72% ose për 1.672.261,00,për shkak të uljes së numrit të të punësuarve në vitin vijues; mëditjet për udhëtime zyrtare në vend janë rritur për 332.83% ,ose për 38.405,00 den,njëjtë edhe mëditjet për këshillin drejtues janë rritur për 327.49% ose për 376.500,00 den.Sponsorizimet me kërkesa për personat fizik janë ulur për 78.57% ose për 3.000,00 den;donacionet për persona fizik janë në ulje prej 37.42% ose për 13.767,00 den;si dhe shpenzimet për sigurim të cilët në tremujorin e tretë të vitit vijues 2018 kanë indeks uljeje prej 78.02% ose në masë për 13.933,00den. Shpenzimet për qarkullimin e pagesave janë rritur për 135.82 % ose për 19.457,00 den;tatimi personal për mjetet e llogaritura dhe të paguara për kontrat pune për punëtorët për punë të përkohshme dhe të çastit janë rritur për 227.31% ose për 262.930,00 den krahasuar me vitin e kaluar.Shërbimet e avokatit në varësi të lëndëve të paditura janë ulur për 85.32% ose për 23.294,00 den;edhe

shërbimet noterike janë paralelisht me numrin e padive të ngritura janë ulur për 970,00 den.Shpërblimet noterike nga lëndët e përmbaruara janë për 62.964,00 den më pak se të vjetshmet.Shpenzimet për regjistrimin e mjeteve themelore në tremujorin e tretë të vitit vijues kanë ulje për 84.53% ose për 1.444,00 den.Shpenzimet e tjera jomateriale që janë të domosdoshme për punën e ndërmarrjes janë rritur për 25.478,00 den në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2017 ose për 222.97% pikë indeksore. Taksat administrative sipas padive të ngritura janë në rritje prej 325.88 %ose për 384,00 den;kamatat nga puna me subjektet e palidhura janë rritur për 1790.63% ose për 39.865,00 den;kamatat ndëshkuese ligjore nga të punuarit sipas aktvendimeve janë në ulje për 52.78% ose për 220.855,00 den.

TABELA nr.3

| | 01.01-30.09.17 | 01.01.30.09.18 | Indeks |
|---|---|---|---|
| 1. Rrogat e llog.bruto | 26.631.020,00 | 28.094.774,00 | 105.5 |
| 2. Kontributet dhe tat.per nga rrogat | 11.385.569,00 | 11.942.471,00 | 104.9 |
| 3. Nr i të punësuarve | 129 | 138 | 106.98 |

Në tabelë,janë të pasqyruara rrogat e llogaritura bruto për të punësuarit,bashkë me kontributet e llogaritura dhe tatimin personal nga rroga.E parë në tërësi treguesit në vitin afarist 2018 janë rritur në krahasim me vitin 2017,për rrogat e llogaritura bruto kemi rritje me indeks prej 105.50 % ose për 1.463.754,00 den, për kontributet e llogaritura dhe taksat e rrogës në tremujorin e tretë,indeksi shënon rritje prej 104.90%ose në masë kemi rritje prej 556.902,00 den. si rezultat i rritjes së numrit të të punësuarve me indeks prej 106.98% përkundër vitit 2017 për periudhën e dhënë.

TABELA nr.4

Krahasimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në dy periudhat e krahasuara dhe rezultati financiar për vitin punues

| | 01.01-30.09 | 01.01-30.09 | |
|---|---|---|---|
| | 2017 | 2018 | INDEKS |
| 1. Të hyrat e përgjithshme<br>2. Të dalurat e përgjth | 45.145.852,00<br>37.841.500,00 | 44.855.771,00<br>37.637.086,00 | 99.36<br>99.46 |
| 3. Humbjet para tat | / | / | / |
| 4. Fitimet para tat. | 7.304.352,00 | 7.218.685,00 | 98.83 |
| 5. Tatim dhe përfitim nga fitimi | / | / | / |
| 6. Fitimi për vitin finan . | / | / | / |
| 7. Humbja nga viti finan | / | / | / |

Në këtë pasqyrë tabelore është pasqyruar rekapitullimi i të hyrave dhe të dalurave,te të hyrat ka ulje për 99.36 % pikë indeksore, ndërsa te të dalurat kemi ulje për 99.46 % pikë indeksore në krahasim me vitin 2017. Për momentin,ndërmarrja jonë publike punon me tregues pozitiv financiar prej 7.218.685,00 den, si rezultat i të hyrave më të mëdha se të dalurat në punë, gjatë vitit punues 2018, njëjtë edhe në vitin 2017,në të cilin për periudhën e dhënë ka tregues pozitiv financiar fitim prej 7.304.352,00 den.Mund të konstatohet se në vitin vijues 2018,përqindja e uljes te shpenzimet është më i madh në krahasim me përqindjen e uljes tek të ardhurat për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2017 dhe i njëjti ndikon rreth rezultatit të punës për tremujorin e dhënë,ose të fitimit të tremujorit të tretë të vitit 2018 e cila është e zvogluar në krahasim me fitimin e tremujorit të tretë të vitit 2017,dhe atë për 85.667,00 den ose 98.83 pikë indeksore.

Fitimi në punë,ndikon rreth rritjes së likuiditetit të ndërmarrjes sonë publike ,për shlyerjen me kohë të detyrimeve ndaj të punësuarve, ndaj shtetit si dhe detyrimeve ndaj furnizuesve për mallin e furnizuar ose për shërbimin e kryer.

Strugë,30.09.2018 NP"KOMUNALE"-Strugë